



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1620/4 prot

Datë 19.06.2026

V E N D I M
Nr. 835 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.06.2026 me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Marketing&Distribution” ShPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-86131-05-19-2026, me objekt: “Blerje bojra për printer dhe fotokopje” me fond limit 6,250,000. lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 01.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Marketing&Distribution” ShPK, me Nipt J72124001N, dhe adresë: *Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, Tiranë.*

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, me Nipt. J62426002Q Adresa: *Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz.
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492, Kamëz, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit janë operatorë ekonomikë ankimues për të njejtën procedurë prokurimi ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.05.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit *“Procedurë e hapur e thjeshtuar”* Mallra, me Nr. REF-86131-05-19-2026, me objekt: *“Blerje bojra per printer dhe fotokopje”* me fond limit 6,250,000. lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 01.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6711 me datë 25.05.2026 dhe me nr. 1620/2026 prot., datë 25.05.2026 e operatorit ekonomik “Marketing&Distribution” ShPK duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën ardhur me shërbim postar me Nr.5998/1 prot., datë 02.06.2026 protokolluar me tonën me Nr. 1620/1 datë 05.06.2026 autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së, referuar të cilit autoritetit kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranim të pjesshëm të pretendimeve të operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6727 me datë 26.05.2026 dhe me nr. 1657/2026 prot., datë 28.05.2026 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.7. Me shkresën ardhur me shërbim postar me Nr. 5998/1 prot., datë 02.06.2026 protokolluar me tonën me Nr. 1657/1 datë 05.06.2026 autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimin e KSHA-së, referuar të cilit autoritetit kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranim të pjesshëm të pretendimeve të operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing&Distribution” ShPK se:

Në shtojcën nr. 8 “ FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE“ Autoriteti kontraktor ka kërkuar Pershkrime të Specifikimeve Teknike Skicimet, parametrat teknik etj: Bashkëlidhur dokumentat në SPE Specifikimi i Materialeve: Bashkëlidhur dokumentat në SPE Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Bashkëlidhur dokumentat në SPE,

Në lidhje me sa është përcaktuar nga ana e juaj **lutemi të hidhni në sistemin elektronik të APP-së dokumentet mbi specifikimet teknike të artikujve të cilët kërkon.** Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipërcekura në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

III.1.1. Autoriteti kontraktor me **Vendimin e KSHA-së** mbi trajtimin e ankesës ka vendosur të pranojë pretendimet e operatorit ekonomik ankimues si vijon:

[...]KSHA pasi u njoh me ankesën e operatorit ekonomik konstatoi se ka pasur një gabim teknik nga ana e njësisë së prokurimit, specifikimet teknike nuk janë bashkëlidhur në dokumentet e tenderit të publikuar. Këto specifikime janë pjesë integrale e dokumentacionit dhe jepen të plota me tabelën bashkëlidhur[...]

Specifikimet teknike për te 46 artikujt

Nr	Emërtim i printerit	Part Number	Sasia	Produkt origjinal i Printerit ose Ekuivalent i tyre , me vula sigurie, shirit sigurie, ne rastet kur aplikohet nga prodhuesi , brenda dates se skadences per artikujt te cilet kane afat skadence.
----	---------------------	-------------	-------	--

Sa me sipër Komisioni Shqyrtimit të Ankesave, mbështetur në nenin 102 të VKM-se date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar:

VENDOSI:

Pranimin pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik.

III.1.2. Neni 30/1 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.

Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. “

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 i. L. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: 1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët

ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, vendos të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Marketing&Distribution” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” mallra, me REF-86131-05-19-2026, me objekt: “Blerje bojra per printer dhe fotokopje” me fond limit 6,250,000. lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 01.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Autoriteti kontraktor të pasqyrojë në shtojcë modifikimet përkatëse për sa është vendosur në Vendimin e KSHA-së.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikim të kriterëve kualifikuese e konkretisht:

Në shtojcën nr. 8 Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/kualifikimit është kërkuar kriteri **2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë e cila të përmbajë:**

- **Në momentin e dorëzimit të mallit tek autoriteti kontraktor, malli do të shoqërohet me deklaratën e cilësisë, origjinës dhe garancisë.** Në lidhje me kriterin e kërkuar sa më sipër ju bëjmë me dije se ky kriter nuk është në proporcion me natyrën e procedurës pasi pasja ose jo e deklaratave nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, pasi një kërkesë e tillë për produktet përcaktohet nga vetë prodhuesit e produkteve. Kërkesa për disponimin e deklaratës, certifikatave të konformitetit ose cilësisë CE/ekuivalent, dhe për çdo produkt certifikatën e origjinës, nuk është e domosdoshme për zbatim me sukses të një kontrate, pasi objekti i kontratës nuk është aq komplekse. Gjithashtu, në bazë të shqyrtimit në DST të procesverbalit për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, gjykojmë, se në lidhje me kriterin e vendosur, autoriteti kontraktor nuk e ka argumentuar teknikisht vendosjen e saj.

Sa më sipër lutemi që kërkesa të merret parasysh duke u hequr si kriter.

Gjithashtu vendosja e një kriteri të tillë bie në kundërshtim; Me nenin 2 të ligjit nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar shtojcën 8, Kriterin 2.3.3 dhe argumentimin e tij si vijon:

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë e cila të përmbajë:

- Në momentin e dorëzimit të mallit tek autoriteti kontraktor, malli do të shoqërohet me deklaratën e cilësisë, origjinës dhe garancisë.

Shënim: Tonerat/bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet part/number-it (Kodit) përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datasheet-in dhe katalogun e printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet. Tonerat/bojërat për printerat dhe fotokopjet ose pajisje të tjera, duhet të jenë origjinale ose ekuivalente, me vulë origjinaliteti, të pahapura, jo të rimbushura dhe jo të ricikluara. Emri i kompanisë prodhuese/marka, duhet të jetë e stampuar dhe e njëjtë në paketim dhe në trupin e tonerave/bojërat, siç aplikohet nga prodhuesi. Kodi tonerit/dramit i pasqyruar në paketim, duhet të korrespondojë me kodin e pasqyruar në trupin e tonerit/dramit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë këtë fakt me qëllim krijimin e sigurisë dhe garancisë për Autoritetin Kontraktor që malli me të cilin do furnizohet ky i fundit, ti përshtatet llojeve dhe pajisjeve të printimit dhe fotokopjimit.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike/kritereve kualifikuese, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Në respekt të parimit të mësipërm, kriteret kualifikuese në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë.

KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i Prokurimeve Publike i parashikon.

Referuar pretendimeve të ankimuesit me anë të të cilit kërkon modifikim të kriterëve për kualifikim, në shtojcën 8, Kriterit **2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë e cila të përmbajë:** Në momentin e dorëzimit të mallit tek autoriteti kontraktor, **malli do të shoqërohet me deklaratën e cilësisë, origjinës dhe garancisë, Komisioni nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit, konstaton se** Autoriteti kontraktor ka përcaktuar gjithashtu një sërë kërkesa siç janë: Kriteret, **2.3.4**, mbi ambalazhimin e mallrave, **2.3.6**. Paraqitja e kataloge, broshura, te dhenat mbi prodhuesit, **2.3.7**, Paraqitje mostra për disa artikuj, apo edhe specifikimet teknike të cilat përmbajnë të dhëna të domosdoshme mbi artikujt bojra printeri, Kriteret/specifikime teknike të vendosura në funksion të cilësisë dhe origjinalitetit apo kompatibilitetit të artikujve objekt prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik, referuar pretendimeve të ankimuesit, gjykon se ankimuesi me të drejtë kundërshton kriterin 2.3.3. me argumente në mënyrë të përmbledhur: *nuk është në proporcion me natyrën e procedurës pasi pasja ose jo e deklaratave nuk varet nga vullneti i*

operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, pasi një kërkesë e tillë për produktet përcaktohet nga vetë prodhuesit e produkteve.[...]

Komisioni referuar dokumentacionit të dosjes, konstaton se autoriteti kontraktor ka kërkuar në kriterin 2.3.3. në formë Deklarate për tu garantuar që ble mallra cilësorë, por gjithashtu AK ka kërkuar që artikujt të kenë paketime të sigurta, me pullë sigurie, me afate skandence, e mbi të gjitha të parimbushura etj, kërkesa të cilat AK i ka renditur në kriteret kualifikuese sipërcituar.

Në këtë kontekst Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit në përputhje me konstatimet e mësipërme, duke hequr përcaktimet **mbi deklarim të origjinës** së artikujve tonera, si kërkesë e tepërt e kriterit 2.3.3, që krijon vështirësi për operatorët ekonomikë të interesur për të marrë pjesë në procedurën objekt shqyrtimi kufizon pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë të biznesit të vogël dhe të mesëm, ngarkon operatorët me detyrime të panevojshme. Komisioni gjykon se Autoriteti Kontraktor ka mundësi të verifikojë cilësinë dhe përputhjen e mallrave objekt oferte nga operatorët me kërkesat e kriteret e vendosura në shtojcën 8.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoritet me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës, referuar nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, 1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër referuar, KPP sjell në vëmendje, se është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë, në rast se operatori ekonomik mund të jetë fitues i mundshëm i procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Në rast të kundërt autoriteti kontraktor zbaton penalitete për operatorët ekonomikë që nuk përmbushin detyrimet e kontratës.

Komisioni gjykon që Autoriteti Kontraktor të modifikojë kriteret 2.3.3. duke hequr fjalën **deklaratë origjine**, nga kriterit.

Për sa më sipër, pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” ShPK:

[...] Specifikimet teknike kanë mangesi/pasaktësi që bëjnë të pamundur identifikimin e sakte të produktit dhe si rrjedhim edhe ofertimin:

a) Per artikullin nr. 2, Printer Lexmark CS410n janë kërkuar tonera me kod 70C1HK0, 70C1HC0, 70C1HM0, 70C1HY0

https://ëëë.lexmark.com/en_us/printers/supply/7587/Lexmark-CS310-CS-CX410-510-Black - Retur n-Program-4K-Toner-Car

Keto tonera me keto kode, nuk punojnë në rajonin tone, por janë për përdorim vetëm në ameriken e veriut. Kodi i sakte për rajonin tone është 70C2HK0, 70C2HC0, 70C2HM0, 70C2HY0

Per sa me siper kerkojme ndryshimin e part number te kerkuar

b) Per artikullin nr. 3 Toshiba E-Studio 2040c eshte kerkuar toner me kod T-FC25-K),T-FC25-C,T-FC25-MT-FC25-Y

Keto kode jane te pa sakta. Kodet e sakta jane T-FC25E-K, T-FC25E-C, T-FC25E-M, T-FC25E-Y

Per sa me siper kerkojme saktesimin e part number te kerkuar

c) Per artikullin nr. 4 Printer me ngjyra Xerox C310 jane kerkuar toner me kod 006R04364,006R04365,006R04366,006R04367, Keto tonera nuk punojne per rajonin tone. Kodet e sakta per te njejtin kapacitet jane : 006R04368 , 006R04369, 006R04370, 006R04371 Per sa me siper kerkojme ndryshimin e part number te kerkuar

d) Per artikullin nr. 5 Pritner Color Advance HP M479 eshte kerkuar toner me kod E2030A/31/32/33 me kapacitet 7500 kopje black,6000 kopje yelloë,6000 kopje magenta,6000 kopje cyan

Kjo eshte e pa mundur pasi kapaciteti maksimal I E2030A/31/32/33 eshte 2400 black dhe 2100 ngjyrat.

Per sa me siper kerkojme ndryshimin e kapacitetit te kerkuar

e) Per artikullin nr. 14 Printer HP 137fnë eshte kerkuar toner me kod W1106A me kapacitet 5000 kopje. Sipas te dhenave te prodhuesit HP, E1106A ka kapacitet 1000 kopje. <https://ëëë.hp.com/ie-en/products/ink-toner/product-details/25101524>

Per sa me siper kerkojme ndryshimin e kapacitetit te kerkuar

f) Per artikullin nr. 27, paisja Xerox B8250, nuk egziston.

Per sa me siper saktesoni paisjen ne perdorim.

III.3.1.Autoriteti kontraktor me **Vendimin e KSHA-së** mbi trajtimin e ankesës ka vendosur të pranojë pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi specifikimet teknike si vijon:

Autoriteti Kontraktor, ka pranuar të publikojë Specifikime Teknike, vendosjen e termit “Ekuivalent” sikurse ka vendosur në tabelën e publikuar në SPE.

Pjese e tabelës se specifikimeve teknike në SPE.

Specifikimet teknike per te 46 artikujt : Produkt origjinal i Printerit ose **Ekuivalent i tyre**, me vula sigurie, shirit sigurie, **ne rastet kur aplikohet nga prodhuesi**, brenda dates se skadences per artikujt te cilet kane afat skadence.

Në lidhje me vendosjen e Kodeve të rajonit për printerat objekt ankime, **KSHA sqaron se :**

Prania e vendosjes se termit **ekuivalente** zgjidh këtë problematikë, i jep të drejtë operatorit të **ofertojë kodet e rajonit European**, përsa kohe ato janë ekuivalente, përputhen teknikisht dhe janë funksionale për pajisjet e AK-së Për rrjedhojë pretendimi i operatorit përmbushet.

Sqarim për sasinë e Art.11. KSHA vleresonte pranoje dhe sqaron :

Persa i perket specifikimit Staples per Cartridge Type X1, gox of 3 – Sqaron sasia 10 eshte perdorur per te percaktuar njesine e furnizimit. Kërkesa është interpretuar dhe është synuar të kërkojë 10 kuti secila nga 3 copë.

III.3.2. Neni 30/1 i L. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje

janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.

Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. “

III.3.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 i. L. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: 1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.3.4. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit *Procedurë e hapur e thjeshtuar* mallra, me REF-86131-05-19-2026, me objekt: “Blerje bojra për printer dhe fotokopje” me fond limit 6,250,000. lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 01.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Autoriteti kontraktor të pasqyrojë në shtojcë modifikimet përkatëse, saktësi të kodeve të artikujve dhe të gjitha sqarimet që ka dhënë për përmbushjen e pretendimeve të ankimuesit siç ka pranuar në Vendimin e KSHA-së në lidhje me specifikimet teknike.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” ShPK:

Në shtojcën 8 (Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit) të DT-së është kërkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë e cila të përmbajë: - Në momentin e dorëzimit të mallit tek autoriteti kontraktor, malli do të shoqërohet me deklaratën e cilësisë,

origjinës dhe garancisë. Në lidhje me kërkesën e AK-së që në momentin e dorëzimit të mallit tek autoriteti kontraktor, malli do të shoqërohet edhe me **deklaratën e origjines**, e gjykojmë si tërësisht të panevojshme pasi, deklarata e origjines nuk tregon asgjë tjetër, vecse vendin ku është prodhuar malli. Per sa kohe qe AK nuk mund te kufizojë origjinën e mallit, cfare rendesie ka se në cfare vendi eshte prodhuar. Gjithashtu, per kete game produktesh, ligjerisht nuk eshte e detyrueshme qe malli te shoqerohet me certifikate origjine ne momentin qe behet zhdoganimi i mallit. Kërkesa në lidhje me origjinën e mallit në rastin e mallrave objekt prokurimi, të cilat janë tonera nuk është proporcionale me objektin e prokurimit dhe nuk i vërteton asgjë të re autoritetit kontraktor për sa i përket cilësisë së tonerave, pasi për AK-në ka rëndësi që tonerat të jenë: - origjinale ose ekuivalente, të pahapura, jo të rimbushura dhe jo të ricikluara; - të jenë të pajisura me pullën e sigurisë së prodhuesit, siç aplikohet nga prodhuesi; - të jenë të ambalazuara sipas kërësive të përcaktuara në DT; - të jenë të përshtatshme me pajisjet ku do të vendosen; kriteri të bëhet: **2.3.3 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë e cila të përmbajë:** - Në momentin e dorëzimit të mallit tek autoriteti kontraktor, malli do të shoqërohet me **deklaratën e cilësisë dhe garancisë.**

III. 3.1. Komisioni për sa i përket pretendimeve mbi modifikime të kriterit 2.3.3. konstaton, se këtë pretendim mbi modifikime në kriterin 2.3.3 e ka ngritur edhe operatori ankimues pararendës “Marketing&Distribution” ShPK në ankesën e tij me nr 1620-2026 prot., mbi të cilën Komisioni ka marrë në shqyrtim pretendimet dhe me argumentet e tij e ka trajtuar në pikën III.2.e vijim, duke vendosur **pranuar pjesërisht pretendimeve** në lidhje me modifikime të kriterit 2.3.3, duke hequr deklaratën për garancinë, duke përmbushur kërkesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK në lidhje me pretendimet e tij.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Office” ShPK: [...] pikës 2.3.4, të shtojcës 8 të DT-së ku është përcaktuar: **2.3.4 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë ku të marrë përsipër që mallrat do të dorëzohen të ambalazuara si më poshtë:**

- **Të jenë të mbështjella në qese në mënyrë hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurtë) dhe të ambalazuara nëpër kuti, të shoqëruara me pulla sigurie nga prodhuesi.**

Shënim: Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë së produktit. Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të kenë emrin e markës në ambalazh dhe në trup, të kenë elementët e sigurisë të padëmtuara

kërkojmë, që të ndryshojë përcaktimi që, ..

Të jenë të mbështjella në qese në mënyrë hermetike . **KËRKOJMË** ndryshimin e specifikimit teknik, duke shtuar togfjaleshin në rastet **kur aplikohet nga prodhuesi** e konkretisht si më poshtë:

Sqarojme se, mënyra e ambalazhimit në rastin konkret e tonerave, është një zgjedhje, një e drejtë dhe një vendimarrje të cilën e ka vetem prodhuesi. **Në mënyrën se si janë kerkuar nga ana juaj, perjashtohet një numer i konsiderueshem prodhuesish, te cilet kanë standartet e tyre te ambalazhimit, te ndryshme nga kërkesat e percaktuara nga ju, por gjithnje, duke plotësuar të gjitha kërkesat dhe standartet e cilesisë.**

III.4.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar shtojcen 8, Kriterin 2.3.4 dhe argumentimin e tij mbi vendosjen e tij si vijon:

2.3.4 Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë ku të marrë përsipër që mallrat do të dorëzohen të ambalazhuara si më poshtë:

- Të jenë të mbështjella në qese në mënyrë hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurtë) dhe të ambalazhuara nëpër kuti, të shoqëruara me pulla sigurie nga prodhuesi.

*Shënim: Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë së produktit. Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të kenë emrin e markës në ambalazh dhe në trup, të kenë elementët e sigurisë të padëmtuara **Sipas OBP-së***

Argumentim: Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se artikujt objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë këtë fakt me qëllim krijimin e sigurisë dhe garancisë për Autoritetin Kontraktor që malli me të cilin do furnizohet ky i fundit, ti përshatet llojeve dhe pajisjeve të printimit dhe fotokopjimit.

III.4.2 Autoriteti me Vendimin e KSHA-së ka trajtuar pretendimin si vijon:

Kriteri 2.3.4 mbi ambalazhimin nuk është vendosur në mënyrë arbitrare nga AK por janë standarde të detyrueshme të përcaktuara në nivel qendror, sipas Katalogut “Blerje Tonerash” të hartuar nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara (OBP) date 10.09.2025 Seksioni 4.1 “Ambalazhimi” ...

III.4.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie

III. 4.4. Në nenin 40, pika 5 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se Autoriteti Kontraktor krahas përshkrimit të saktë të nevojave të tij duhet të përcaktojë specifikimet teknike/kritere dhe cdo kërkesë në mënyrë të qartë duke përshkruar karakteristikat e mallrave objekt prokurimi me qëllim për të përftuar produktet që autoritetit i duhen. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit në përcaktimin e kriterëve në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe si rrjedhojë është në të drejtën e tij për të përcaktuar kërkesa në lidhje me artikujt e kërkuar të jenë përshkrime të sakta e të mos krijojnë konfuzion, të mirëargumentojë vendosjen e tyre për mallrat që do të prokurojnë, me qëllim që të orientojnë operatorët ekonomikë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në përcaktimin e kërkesave për kualifikim duhet të ketë parasysh që të mos krijojnë konfuzion, si edhe të lehtësojnë punën e operatorëve ekonomikë, ndaj dhe referuar ankesës së operatorit ekonomik, konstatoi se ankimuesi me të drejtë kërkon modifikime duke vendosur fjalinë alternative “**në rastet kur aplikohet nga prodhuesi**”, argumentuar se kriteri ka përcaktime të pamundura që një pjesë e tyre nuk varen nga operatorët ekonomikë.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se kriteri i vendosur nga AK për Mallrat - *Të jenë të mbështjella në qese në mënyrë hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurtë) dhe të ambalazuara nëpër kuti, të shoqëruara me pulla sigurie nga prodhuesi*, është vendosur në funksion të sigurisë së mallrave dhe ruajtjes së tyre nga agjentët atmosferikë apo edhe ruajtjen në magazinat dhe si kriter qëndron, por vendosja e opsionit **në rastet kur aplikohet nga prodhuesi**, sugjeruar nga ankimuesi jep mundësi operatorëve të ofertojnë me larmi mallrash në përputhje me specifikimet teknike për mallra të sigurt.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për procedurën e prokurimit ka detyrë të mirëargumentojë bindshëm vendosjen e specifikimeve teknike dhe kriteret të qarta, dhe kërkesa për kualifikim për artikujt e kërkuar të jenë në proporcion me fondin limit, sasinë e kërkuar apo edhe natyrën e procedurës objekt shqyrtimi, në funksion të realizimit me sukses të kontratës por edhe të realizueshme nga operatorët ekonomikë.

Komisioni gjithashtu sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, përgjegjësinë thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës e ka autoriteti kontraktor, i cili ndjek me përpikmëri dhe në cdo detaj realizimin e kontratës dhe verifikimin e mallit duke aplikuar sanksione në rast mosrealizimit të kontratës nga operatori ekonomik fitues.

Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin objekt ankimi duke shtuar fjalë/togjalëshin **në rastet kur aplikohet nga prodhuesi**, me qëllim për të hapur konkurrencën me pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë përfaqësuesi të biznesëve të niveleve të ndryshme, të mesëm dhe të vegjël.

Përsa referuar më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik në lidhje me kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.6 të shtojcës 8 të Dt-së, ku është kërkuar:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/broshurë ose fragment katalogu ose broshurë nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij, për të gjithë artikujt e tjere (pervec ato të kerkuar si mostra), i cili duhet të përmbajë minimalisht keto të dhena: artikull nr, emertimi, prodhuesi, ngjyra, kodi i produktit, numri i faqeve, foto ose linku ku mund të gjenden të dhënat e artikullit. Në rastin kur katalog/broshurë nuk është në gjuhen shqipe, duhet të jetë i perkthyer ne gjuhen shqipe dhe i noterizuar.kërkojmë ndryshimin e tij me argumentat si më poshtë vijon:

Në pikën I të kësaj ankese, kemi argumentuar se, në shtojcën 6 (Formulari i Specifikimeve Teknike) të Dt-së, ku është përcaktuar se: ...Skicimet, parametrat teknik etj: Bashkëlidhur dokumentat në SPE Specifikimi i Materialeve: Bashkëlidhur dokumentat në SPE Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Bashkëlidhur dokumentat në SPE...?, rezulton se nga AK-JA nuk është publikuar dokumenti i referuar si më sipër në shtojcën 6 të Dt-së, pasi në SPE, në dokumentat e hedhura për këtë procedurë prokurimi nuk rezulton të jetë ngarkuar ndonjë dokument ku të jenë përcaktuar specifikimet teknike të artikujve të kërkuar, përfshirë këstu edhe numrin e faqeve që duhet të realizojë cdo toner. **Numri i faqeve që duhet të printojnë tonerat e kërkuara nga AK-ja, nuk rezulton të jenë përcaktuara as në shtojcën 7 (FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT) të Dt-së.**

Sa më sipër, nuk ka asnjë sens t i kërkohet ofertuesve të paraqesin katalog/broshure ose fragment katalogu ose broshure nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij, per te gjithë artikujt e tjere (pervec ato te kerkuar si mostra), i cili duhet te permbaje numrin e faqeve që printon. AK-ja ka kërkuar të përcaktohen në katalog apo në broshurë numri I faqeve që printon seicili nga tonerat e kërkuara ndërkohë që vetë AK-ja nuk ka përcaktuar as një kërkesë për numrin e faqeve që duhet të realizojnë tonerat e kërkuara.

Sa më sipër, me qëllim vendosjen në pozita të barabarta të ofertuesve, është e rëndësishme që AK-ja të përcaktojë numrin minimal të faqeve që duhet të printojë cdo toner, pasi tonera të cilët printojnë numra të ndryshëm faqesh, sigurisht kanë cmime të ndryshme në treg, në varësi edhe të umrit të faqeve që ato printojnë.

III.5.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST, shtojcen 8, **Kriterin 2.3.6**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/broshure ose fragment katalogu ose broshure nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij, per te gjithë artikujt e tjere (pervec ato te kerkuar si mostra), i cili duhet te permbaje minimalisht keto te dhena: artikull nr., emertimi, prodhuesi, ngjyra, kodi i produktit, numri i faqeve, foto ose linku ku mund te gjenden te dhenat e artikullit. Në rastin kur katalog/broshure nuk eshte ne gjuhen shqipe, duhet te jete i perkthyer ne gjuhen shqipe dhe i noterizuar.

Argumentimi: *Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike. Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Paraqitja e katalogjeve per zerat e mallrave, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise se mallrave qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST.*

III.5.2 Neni 40 pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*
a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.5.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës rëndësisë dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë si gjatë hartimit të DST por edhe në vlerësimin e ofertuesve në procedurën objekt shqyrtimi.

III.5.4. Referuar shtojcës 8, 2.3. “Kapaciteti teknik” i dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka vendosur **kriterin 2.3.6.** me qëllim dhënien e informacionit të nevojshëm për artikujt objekt-prokurimi dhe nga formulimi i tij Komisioni konstaton se Autoriteti kontraktor nuk ka vendosur kërkesa për paraqitje të një dokumenti, por ka kërkuar dokumente alternativë si: katalog/broshurë ose fragment katalogu ose broshurë nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij, për të gjithë artikujt e tjere (përveç ato të kërkuar si mostra), me qëllim për të dhënë mundësi operatorëve në përmbushje të kriterit për dhënie informacione të hollësishme, sic janë cilësia e bojrave por edhe numri i faqeve për bojrat, për të cilat ankimesi ngre pretendime..

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa nuk është aspak kufizuese dhe se kriteri i vendosur është në proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të mallrave për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës rëndësisë dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni gjykon se kriteri 2.3.6 nuk është diskriminues, janë vendosur materiale alternative me anë të të cilave kërkohet informacionet e plota në lidhje me mallrat objekt prokurimi .

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Marketing&Distribution” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-86131-05-19-2026, me objekt: “Blerje bojra per printer dhe fotokopje” me fond limit 6,250,000. lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 01.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Marketing&Distribution” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.
4. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
5. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me vendimet e KSHA-së si edhe me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
6. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, dhe të hartojë shtojcën me modifikimet përkatëse dhe të gjitha sqarimet e kërkuar sipas konstatimeve të këtij vendimi.
7. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing&Distribution” SHPK.
8. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.
9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiovent Zguro

